



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 221 Prot

Tiranë, më 10.03.2022

**V E N D I M**

Nr.37, datë 10.03.2022

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr. 12282, datë 1.7.2020, për transferimin e përkohshëm të nëpunësit \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

**Vërej se:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 746 prot., datë 19.7.2021, nga nëpunësi doganor \*\*\*\*\*, është ngritur pretendimi se, transferimi i tij i përkohshëm për nevoja të institucionit, në pozicionin “Specialist”, Dega Doganore Fier, është i padrejtë, pasi ai, pas ristrukturimit të institucionit, ka emërim të përhershëm në pozicionin “Specialist në Sektorin e Intelegjencës Operative”, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, pranë DPD dhe veç kësaj, në kushtet kur ka mbaruar afati maksimal 6-mujor i transferimit të përkohshëm, ai duhet të kthehet në vendin e tij të punës.

Nga hetimi administrativ i kryer në këtë rast dhe pas analizës së dokumentacionit të çështjes, rezulton e vërtetuar që, pas kryerjes së ristrukturimit të fundit në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi ka shqyrtuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit të DPD,

ndërmjet të tjerave, me aktin nr. 7792/136, datë 1.11.2018, ka miratuar transferimin e përhershëm të nëpunësit doganor \*\*\*\*\* në pozicionin e kategorisë C1, “*Specialist në Sektorin e Intelgjencës Operative*”, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, pranë DPD dhe mbi këtë bazë, ka dalë akti nr. 27281, datë 15.11.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për emërimin e tij në pozicionin e mësipërm.

Veprimet janë kryer në përputhje me rregullat e përcaktuara për rastet e ristrukturimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe dispozitat e legjislacionit doganor (pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht që në administrimin e shërbimit doganor, krahas dispozitave të posaçme të Kodit Doganor, zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil.

Disa kohë, pasi ka marrë emërimin e mësipërm në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Intelgjencës Operative*”, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, pranë DPD, rezulton se për nevoja të institucionit, me aktin nr. 12282, datë 1.7.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, punonjësi në fjalë, është transferuar përkohësisht në pozicionin “*Specialist*”, Dega Doganore Fier (ku vazhdon të punojë aktualisht).

Pas plotësimit të afatit maksimal 6-mujor të transferimit, nëpunësi doganor \*\*\*\*\* nëpërmjet një kërkesë drejtuar titullarit të institucionit (datë 6.1.2021, e cila është përsëritur edhe në datën 19.7.2021), ka kërkuar kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm të punës “*Specialist në Sektorin e Intelgjencës Operative*” në Drejtorinë e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, pranë DPD. Kësaj kërkesë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, i është përgjigjur se, transferimi është kryer në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe kërkesave specifike të Kodit Doganor në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësve doganorë, duke nënvizuar se, problemi do të ndiqej në vijimësi nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit në varësi të nevojave të punës si dhe të rregullave të përcaktuara nga ky legjislacion (shkresa kthim përgjigje nr. 170/1, datë 25.1.2021).

Në kushtet kur pas kthimit të kësaj përgjigje, nuk pati një reagim tjetër nga ana e institucionit, tashmë kur afati 6-mujor i transferimit të përkohshëm është tejkaluar dukshëm, punonjësi në fjalë, ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë dhe kthimin e tij në vendin e punës si “*Specialist në Sektorin e Intelgjencës Operative*”, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, pranë DPD, ku ka emërimin e rregullt.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të transferimit të përkohshëm në këtë rast, që në çastin e parë evidentohet fakti që, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të tij (pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor), janë

parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a” parashikon: “*Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njejtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.*

Siç shihet, në germën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, sipas së cilës mund të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (*njëherësh ose e copëzuar*) për nevoja të punës, por kjo jo më shumë se një periudhë 6-mujore, gjatë dy viteve. Kjo do të thotë që, një nëpunës doganor mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa herë lind e nevojshme diçka e tillë, pa patur ndonjë kufizim të shprehur ligjor në shpeshhtësi, prandaj në këtë vështrim nuk mund të pranohet pretendimi se, transferimi i përkohshëm është i padrejtë për shkak se nëpunësi në fjalë ka emërim definitiv pas ristrukturimit të institucionit.

Akti i mësipërm, nga pikpamja procedurale është i ligjshëm, pasi ka dalë nga organi kompetent, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, siç parashikon pika 17, Kreu V, “*Transferimi i përkohshëm*”, e Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për personelin e administratës doganore*”, i ndryshuar dhe është ruajtur kategoria e pozicionit dhe niveli i pagës që ai ka patur në pozicionin e mëparshëm (*kategoria III-b*).

Nga sa analizuam më sipër, arrihet në përfundimin se, transferimi i përkohshëm i punonjësit doganor \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist*”, Dega Doganore Fier, është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në lidhje me transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor.

Më tej, duke e parë në brendësi përmbajtjen e aktit nr. 9340, datë 26.5.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, rezulton se, transferimi i përkohshëm, vërtet është bërë për nevoja të institucionit (*pika 7, shkronja “a” (i), e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i RSH”*) por në akt nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur afati i transferimit. Në lidhje me këtë mangësi, nga ana e institucionit arsyetohet se, meqë dispozita referuese e aktit e parashikon në mënyrë të shprehur afatin maksimal të një transferimi të përkohshëm, kohëzgjatja prezumohet që nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.

Kjo mangësi vlerësohet si një element paligjshmërie i aktit të transferimit, pasi si rregull në akt duhet të përcaktohet në mënyrë të shprehur koha e transferimit të përkohshëm dhe data e kthimit të nëpunësit në pozicionin e mëparshëm, gjë e cila do të siguronte një stabilitet në marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil dhe transparencën e nevojshme, duke i siguruar nëpunësit mundësinë që të kërkojë konkretisht rivendosjen e të drejtës së tij.

Shkelja e mësipërme e lejuar në këtë rast, ka krijuar kushte për mosrespektimin e pikës 7/c, të nenit 15, të Kodit Doganor, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur: *“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar”*.

Në kushtet kur vërtetohet që afati 6-mujor i transferimit të nëpunësit \*\*\*\*\* ka përfunduar në muajin Janar 2021 dhe tashmë është tejkaluar në mënyrë të dukshme, si dhe kur nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor të parashikuar në ligj, ky punonjës duhej të ishte rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, duke theksuar faktin se, nëpunësi doganor mund të transferohet për një afat tjetër, në vazhdim apo me përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme, të argumentuar, duke përcaktuar saktë afatet e transferimit dhe duke mbajtur parasysh parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, parashikuar përkatësisht në nenet 12 e 17, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”*.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin e punës *“Specialist në Sektorin e Intelgjencës Operative”*, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit, pranë DPD, ku ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati maksimal 6-mujor i transferimit, në zbatim të shkronjës “a”, pika 7, të nenit 15, të ligjit nr.102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar.

2. Për kryerjen e veprimeve administrative, lihet afat **15** ditë, nga marrja dijani për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia e burimeve njerëzore të institucionit është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**